# DËSHMI ARKIVI

**A-473344**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Poezia e Dhimitër Pojanakut, një mbrëmje mes vargut, muzikës dhe emocioneve |
| ADRESA | `https://www.cna.al/kulture/poezia-e-dhimiter-pojanakut-nje-mbremje-mes-vargut-muzikes-dhe-emocionev-i475316` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 09:43:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 09:38:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3983a76ac67ae663949e18226bd4e408fb86eb65bedaed942e70896797e0a594` |
| TEKSTI | `a7cf41fa4f9b1792407c42a3e931ad33f73e5b6f170986bd422a00653f9293f5` |
| PAMJA | `80c764b4033e419ebf993b3977a684d5fbff3cb858bde89079e49f87b525ca27` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `79b48b69de450e9a9c2485c7ce95a1667acf423241173fc728411ce7436ec88b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/79b48b69de450e9a9c2485c7ce95a1667acf423241173fc728411ce7436ec88b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

### E fundit!

x

11:38 Kulturë

Një mbrëmje kushtuar poezisë, artit dhe krijimtarisë së po...

# Poezia e Dhimitër Pojanakut, një mbrëmje mes vargut, muzikës dhe emocioneve

27 Shtator 2026, 11:38, Kulturë CNA

Një mbrëmje kushtuar poezisë, artit dhe krijimtarisë së poetit Dhimitër Pojanaku u shndërrua në një takim të veçantë mes autorit dhe publikut pogradecar. Recitali poetik u konceptua si një performancë ndryshe, ku poezia u ndërthur me muzikën dhe interpretimin.

Në qendër të mbrëmjes ishte edhe promovimi i përmbledhjes poetike "Qielli ngrin", një botim që, sipas redaktorit Ilir Shyta, përmbledh një pjesë të rëndësishme të krijimtarisë poetike të Pojanakut.





“Recitali poetik, në vetvete, kishte gjithë lumnimin e artit të poezisë në vitet e Pojanakut, sepse u finalizua pikërisht me botimin e librit, një përmbledhje me poezi, ‘Qëlli ngrin’. U bashkuan dy gëzime në një ditë: ditëlindja e poetit dhe promovimi i librit.”

Mbrëmja solli vargje, muzikë dhe emocion, ndërsa disa prej poezive të autorit u sollën edhe përmes interpretimit dhe këngës"

Për botuesin Bujar Hudhri, bashkëpunimi mes autorit, redaktorit dhe botuesit është një proces i rëndësishëm për ndërtimin e një vepre me vlera për lexuesin.



“Ne punojmë me redaktorë shumë të mirë, sepse pikërisht ky është thelbi: që ta kuptosh autorin si njeri, atë që ai vetë shkruan dhe përvojën që ti ke. Të gjitha këto, në sinkron, bëjnë që të kemi një libër i cili të ketë vlera për lexuesin.”

Ndryshe nga një promovim tradicional, kjo mbrëmje u konceptua si një recital, miqtë e poetit u bënë pjesë e drejtpërdrejtë e performancës, duke i dhënë poezisë një tjetër dimension.





> “Ishte një recital poetik në një formë krejt ndryshe nga ç’kishim parë më parë. Gjithçka ishte konceptuar me praninë e miqve të mi, të cilët u bënë njëkohësisht edhe aktorë, duke e sjellë poezinë në një tjetër dimension", tha poeti Dhimitër Pojanaku.

Përmes vargut, interpretimit dhe muzikës, poeti solli një mbrëmje ku fjala poetike u kthye në përjetim skenik. Një festë e dyfishtë, 70 vjetori i autorit dhe promovimi i librit të fundit.








## Të sugjeruara

### In memoriam/ Teodor Laço, rrëfimtari e protagonisti i letrave dhe politikës shqiptare

Fshati Vuno shpallet "Qendër Historike"/ Bëhet pjesë e listës së Pasurive Kulturore të Paluajtshme

"Zemra e Jezusit" e çeliktë hap krahët në një përqafim të qiellit

Kërkimet arkeologjike në Lin/ Konfirmohet shtrirja e sitit palafit mbi 6 hektarë

Korça, arenë e muzikës në "Serenights Festival"/ Artistët tregojnë emocionet për CNA

Shkrimtari i njohur shpallet "Qytetar Nderi" i Kolonjës

"Serenights Festival"/ Mes traditës dhe muzikës bashkëkohore, Korça bashkon brezat

Nis edicioni i tretë i “Serenights festival” në Korçë

Guximi i katër të rinjve/ Si djemtë e Shkollës Teknike elektrifikuan Durrësin më 1930

Një jetë në artin shqiptar/ Reshat Arbana feston 86-vjetorin e lindjes

“Ditëlindja” letrare në Pogradec/ Promovohet novela e autorit Fate Velaj

Letërkëmbimi pasionant mes Albert Kamy dhe Simone de Beauvoir, dy prej mendjet më brilante të një shekulli

Shqipëria ka qenë toka e njeriut të lirë, e njeriut të ashpër dhe zemërmirë...

Për Valin e Martaneshit/ Fshati i Babëgjyshit, fshati më i mirë…

"Njeriu po e shkatërron Tokën"/ Patriarku Bartolome ndan mesazh kumbues për krizën ekologjike

Piketakimi në Pogradec/ Nis edicioni i 17-të i Kolonisë Ndërkombëtare të Artit

Ngre siparin edicioni i 13-të i "KoKo Fest"/ Mozaik shfaqjesh dhe artistësh në Korçë

Eteri kundër hapësirës dhe kohës, fushëbeteja ku gjenitë e shkencës u përplasën

Holanda tërhiqet nga Eurovision 2027: Konkursi nuk është më neutral

Vincenzo Peruggia, ai që vodhi Mona Lizën e Leonardo da Vincit, duke e ngjitur atë në panteonin e kryeveprës



Vincenzo Peruggia, ai që vodhi Mona Lizën e Leonardo da Vinçit, duke e ngjitur atë në panteonin e kryeveprës

editorial

09:11 Editorial Bujar Leskaj

**Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!**

**CNA LIVESTREAM**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.